



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr. 34/39 Prot

Datë 30/06 2018



**Udhëzues për institucionalizimin e  
marrëdhënieve të KLSH-së  
me Parlamentin**

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
<b>HYRJA</b>	<b>1</b>
<b>KAPITULLI I. MISIONI VIZIONI DHE PARIMET E PARTNERITETIT KLSH-PARLAMENT</b>	<b>6</b>
<b>KAPITULLI II. KUADRI AKTUAL I KOMUNIKIMIT MES KLSH-SË DHE KUVENDIT TË SHQIPËRISË</b>	<b>8</b>
<b>KAPITULLI III. INSTRUMENTET E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME PARLAMENTIN</b>	<b>16</b>
<b>KAPITULLI IV. HAPAT PËR INSTITUCIONALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE TË KLSH ME PARLAMENTIN</b>	<b>20</b>
<b>SHTOJCA 1 : REZOLUTA E KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KLSH-SE PËR VITIN 2015</b>	
<b>SHTOJCA 2 : PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NR. 1064/4 PROT, DATË 26/12/2016</b>	

## HYRJE

KLSH, në kuadrin e reformimit institucional e ka konsideruar zhvillimin e marrëdhënieve me Kuvendin e Shqipërisë si një prej aspekteve më të rëndësishme të procesit të kryerjes së reformave drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe modernizimit institucional.

Në Deklaratën e Limës, e quajtur ndryshe “Magna Carta”, Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) theksohet se: *“Institucioni Suprem i Auditimit duhet të fuqizohet dhe të mandatohet nga Kushtetuta për t’i raportuar në mënyrë të pavarur dhe çdo vit gjetjet e tij Parlamentit ose çdo organi tjetër kompetent publik; ky raport duhet të publikohet. Kjo do të sigurojë shpërndarje të gjerë dhe diskutim, duke rritur mundësitë për zbatimin e gjetjeve të Institucionit Suprem të Auditimit”*<sup>1</sup>

Ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve efektive të KLSH-së me Parlamentin në vijimësi është orientuar drejt zbatimit rigoroz të kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe Parimeve e Praktikave më të mira të rekomanduara nga Bashkimit Europian për marrëdhëniet midis Parlamentit dhe Institucioneve Supreme të Auditimit.

Po kështu ISSAI 12 “Vlerat dhe dobitë e Institucionet Supreme të Auditimit-të sjellësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”, Parimi 6 “Komunikimi efektiv me Parlamentin dhe palët e tjera të interesuara” u kërkon SAI-ve të zhvillojnë marrëdhënie profesionale me Parlamentin dhe partnerët e tjerë, duke *“...komunikuar me Parlamentin dhe veprimtarët e tjerë të interesuar në një mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësisive të SAI-t si një auditues i pavarur i sektorit publik”*<sup>2</sup>.

Në frymën e Përcaktimeve të Deklaratës së Limës dhe standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës, **Kryetari i KLSH-së**, në Platformen Strategjike<sup>3</sup> për zhvillimin e KLSH-së, paraqitur në dhjetor 2011 në Komisionin e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, theksoi *qasjen e KLSH-së* për institucionalizimin e një marrëdhënie efektive të KLSH-se me Parlamentin në 7 vitet e ardhshme:

- *“Intensifikimi i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011- 2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues...*
- *Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat”.*

KLSH, në kuadrin e reformimit institucional *pas vitit 2011 zhvillimin e marrëdhënieve efektive me parlamentin* e ka konsideruar *si shtyllën prioritare* të procesit drejt modernizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke synuar në rritjen e pritshmërive të rolit të Parlamentit në zinxhirin e llogaridhënies për administrimin efektiv të fondeve publike.

<sup>1</sup> Deklarata e Limës, Lima, Peru, 1977, [http://www.issai.org/media/12901/issai\\_1\\_e.pdf](http://www.issai.org/media/12901/issai_1_e.pdf) dhe [www.klsh.org.al/seria](http://www.klsh.org.al/seria) botime klsh.2012

<sup>2</sup> [www.klsh.org.al/seria](http://www.klsh.org.al/seria) botime KLSH.

<sup>3</sup> [www.klsh.org.al/home/KLSH/Plani Strategjik/Projekt-Ide](http://www.klsh.org.al/home/KLSH/Plani%20Strategjik/Projekt-Ide)

Udhëzuesi "Për institucionalizimin e marrëdhënieve efektive të KLSH-së me Parlamentin" ofron qasjen strategjike të institucionit në një linjë me frymën dhe mesazhet e përcjella nga dy rezolutat e miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në kuadrin e Axhendës së saj të Zhvillimit post 2015:

i) *Rezolutën A/66/209 "Nxitja e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit", e cila i inkurajon Shtetet Anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të "aplikojnë parimet e vendosura në Deklaratën e Limës dhe në Deklaratën e Meksikos, si dhe të intensifikojnë bashkëpunimin me INTOSAI-n, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të SAI-t".*

ii) *Rezolutën A/69/228: "Promovimi dhe fuqizimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, me anë të forcimit të institucioneve të larta të auditimit" e cila inkurajon Shtetet Anëtare dhe Parlamentet e tyre "t'i kushtojnë vëmendjen e duhur pavarësisht dhe ngritjes së kapaciteteve të SAI-ve, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare, ashtu si edhe përmirësimit të sistemeve publike kontabël, në përputhje me planet kombëtare për zhvillim në kuadrin e Axhendës për Zhvillim Post 2015".*

Me anë të tyre, OKB nxit parlamentet e Shteteve Anëtare të OKB-së të forcojnë pavarësinë e SAI-ve të vendeve të tyre dhe të bashkëpunojnë më fort me to. Miratimi i Rezolutave përbën kurorëzimin e përpjekjeve të SAI-ve nga i gjithë globi, në një lobim konkret dhe të mirë organizuar nga ana e Organizatës së tyre INTOSAI.

Mbështetur në sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), si Institucioni më i lartë i kontrollit Ekonomiko-Financiar në vend, është udhëhequr nga parimi i përmbushjes së detyrimeve kushtetuese ligjore, duke vepruar "*si agjent i Kuvendit*" për të siguruar miradministrimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve shtetërore.

Nën këtë fokusim KLSH, marrëdhëniet me Parlamentin, i ka konsideruar si dy elementë të një sistemi të balancuar të llogaridhënies së Ekzekutivit tek palët e interesit.

Në funksion të një marrëdhënie efektive frytdhënëse konstruktive me Parlamentin, KLSH në vijimësi është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve Kushtetuese ligjore të KLSH-së duke i mundësuar Kuvendit si një prej komponentëve kryesorë të Trekëndëshit të Llogaridhënies publike të ushtrojë mbikëqyrjen parlamentare me qëllim rritjen e transparencës së përdorimit të parasë publike.

Udhëzuesi "Mbi institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin" synon intensifikimin dhe avancimin në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve me Kuvendin e Shqipërisë duke shërbyer si një instrument efektiv dhe funksional në përmbushje të motos së Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për vitet 2018-2022 "*KLSH, shërbestar i qytetarit*".

Stadi aktual i zhvillimeve të marrëdhënies që KLSH, ka me Kuvendin e Shqipërisë e sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, reflektojnë kërkesat e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t për më shumë përgjegjësi në sistemin e llogaridhënies për përdorimin e fondeve publike, në veçanti të ISSAI-t 20, "Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies", Parimi 7 sipas të cilit "*SAI-t duhet të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura*".

Dokumenti “Mbi institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin” përbën një platformë udhërrëfyese për sigurimin e vazhdimësisë së arritjeve të deritanishme të KLSH-së në marrëdhënie me Kuvendin, në hartimin e politikave menaxheriale, në forcimin dhe funksionimin e një sistemi efektiv të transparencës institucionale.

Udhëzuesi është në një linjë me objektivat Strategjike të Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022 si dhe me dy planet strategjike të organizmave ndërkombëtare të Planit strategjik të EUROSAT-t 2017-2023 dhe Planit Strategjik të INTOSAI-t 2017-2022. Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Kuvendi i Shqipërisë është përcaktuar si një nga partnerët strategjikë kryesorë dhe **faktor nxitës i zhvillimit** dhe menaxhimit të ndryshimit dhe modernizimit të KLSH-së. Në pikën 4 të Strategjisë së Zhvillimit “Partnerët Strategjikë” është përcaktuar:

*“Cilësia dhe besueshmëria e raporteve të auditimeve të KLSH po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e parlamentarëve, duke rritur mundësinë e funksionimit të mekanizmave të “Trekëndëshit të Llogaridhënies” (SAI-Parlament-Qeveri), pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, duke kontribuar për mirëqeverisjen e vendit”<sup>4</sup>.*

Kryetari i KLSH-së ka deklaruar kolonat ku mbështetet bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë, të cilat do të shërbejnë dhe si shtyllat bazë referuese të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve efektive me Parlamentin. Këto shtylla paraqiten si më poshtë.



<sup>4</sup> Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, faqe 39, paragrafi i parë.

Ky Udhëzues u përgatit bazuar në përmbushjen e detyrimeve Kushtetuese dhe Ligjore të KLSH-së ndaj Parlamentit si dhe në një sërë dokumentesh të rëndësishëm rrjedhojë e bashkëpunimit dhe partneritetit institucional, sikurse janë rekomandimet e dhëna nga ekspertët<sup>5</sup> e Projektit IPA 2013, “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”, financuar nga BE, duke integruar në të dhe dokumentet, rekomandimet e dhëna nga raportet dhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare si:

- DG-Budget, nëpërmjet Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë;
  - Vlerësimet e SIGMA-s, nëpërmjet raporteve të monitorimit;
  - Parimet e Administratës Publike për vendet e Zgjerimit të BE-së;
  - Dokumenti PEFA 2016 , Kuadri për vlerësimin e menaxhimit të financave publike<sup>6</sup>
  - Raporti i rishikimit mes kolegëve “Peer Review”, i realizuar nga ekspertët e Gjykatës Austriake të Auditimit në vitin 2016;
  - Rekomandimet nga ekspertët e SAI-ve të përparuar të Evropës, GAO-s (Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-ve) dhe ECA-s (Gjykatës Evropiane të Audituesve), etj.
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI-t, të cilat janë shtylla referuese kryesore për formulimin e këtij dokumenti dhe konkretisht:
- ISSAI 1, “ Deklarata e Limës”;
  - ISSAI 10, “Deklarata e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve”;
  - ISSAI 12, “Vlerat dhe dobitë e SAI-ve : të sjellesh ndryshimin në jetën e qytetarëve”;
  - ISSAI 20, “Parimet e transparencës dhe llogaridhënies”.

Krahas sa më sipër në këtë dokument janë reflektuar qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në dy dokumentet kryesorë të zhvillimit të KLSH-së për periudhat në vijim :

- 1- Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së, 2018-2022;
- 2- Strategjia e Komunikimit të KLSH-së, 2017-2019;

Si kuadër referues në këtë dokument ka shërbyer dhe Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr. 49/2017 *‘Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj’*.

Po kështu janë reflektuar dhe vlerësimet dhe rekomandimet e rezultuara nga aplikimi i instrumenteve të vetëvlerësimit lancuar nga INTOSAI “ PMF Instrument “ sikurse është Raporti i vlerësimit të performancës së KLSH-së bazuar në Kornizën e Matjes së Performancës <sup>7</sup>.

Krahas sa më sipër në përgatitjen e këtij udhëzuesi janë marrë në konsideratë praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe propozimet dhe sugjerimet e projektit “Transparenca në sistemin shëndetësor në Shqipëri” financuar nga USAID, zbatuar nga University Research Co., LLC.

<sup>5</sup> Misioni 1.2.1.1, “Një analizë e rregullave ligjore dhe praktikës së KLSH-së me Parlamentin. Zhvillimi i projekt-udhëzimeve për institucionalizimin e marrëdhënieve me Parlamentin. Zhvillimi i programit dhe masat për zbatimin e projekt-udhëzimeve për institucionalizimin e marrëdhënieve me Parlamentin”.

<sup>6</sup> PEFA 2016, Kuadri për vlerësimin e menaxhimit të financave publike, Sekretariati i PEFA-s, Ushangton.<https://pefa.org>

<sup>7</sup> Raporti i Performancës Vjetore të KLSH-së vitet 2015,2016,2017 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

- Rezolutën A/66/209 "Nxitja e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit" (22 Dhjetor 2011);
- Rezolutën A/69/228: "Promovimi dhe fuqizimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, me anë të forcimit të institucioneve të larta të auditimit" (19 Dhjetor 2014).
- Dokumentet e Konferencave të organizuara në nivel rajonal si:  
 Dokumenti i Marrëveshjes së Stambollit, në të cilën SAI-t u dakortësuan për: "Angazhimin për të vazhduar të luajmë rolin tonë në zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve pozitive mes SAI-ve dhe Parlamenteve kombëtare, bazuar në respektin e ndërsjelltë për rolin dhe pavarësinë e të dy palëve;
- Dokumenti i Rezolutës e Konferencës së 19 Nëntorit 2013 e organizuar në Budva në Mal të Zi "Mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve";  
 Dokumentet e Takimit të Shtatorit 2016 në Ankara të Turqisë të rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidatë dhe para-kandidatë.
- Dokumentet e gjeneruar nga SIGMA " Zhvillimi i Marrëdhënieve efektive të punës midis SAI-ve dhe Parlamenteve nr.33 i vitit 2002 dhe nr. 54 i vitit 2017.
- Botimi i KLSH-së, "Eksperienca e vendeve Europiane në auditimin e jashtëm publik";

## I. MISIONI VIZIONI DHE PARIMET E PARTNERITETIT KLSH-PARLAMENT

Udhëzuesi “ Mbi marrëdhëniet efektive të KLSH-së me Parlamentin” synon konsolidimin e platformës së bashkëpunimit konstruktiv midis dy institucioneve me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese ligjore dhe të atyre që derivojnë nga realizimi i Misionit dhe Vizionit të Zhvillimit Institucional.

**Misioni:** KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që të shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

**Vizioni:** KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Dokumenti adreson objektivat, hapat që do të ndiqen si dhe instrumentet që do të përdoren bazuar në vlerat dhe parimet e KLSH, të cilat mbështeten në Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit (ISSAI), dhe veçanërisht në parimet e ISSAI 12, “Vlera dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit - të sjellësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”.

**Parimet e partneritetit dhe bashkëpunimit të KLSH-së në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga misioni, vizioni institucional janë:**

1-PAVARËSIA

5-INTEGRITETI

2-PROFESIONALIZMI

6-OBJEKTIVITETI

3-BASHKËPUNIMI

7-VLERA E SHTUAR

4-PËRGJEGJSHMËRIA

8-TRANSPARENCA



**Parimet e Kuvendit për bashkëpunim dhe partneritet në funksion të mbikqyrjes parlamentare janë:**


**1-LLOGARIDHËNIA**

**3-KONTROLLI I QEVERISË**

**2-KORPUSI LIGJOR**

**4-NDJEKJA E REKOMANDIMEVE  
TE KLSH-SË**

Mesazhet e përcjella nga Kongreset e XXI dhe XXII të INTOSAI-t: “Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare”<sup>8</sup>, “Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-et) në shërbim të qytetarëve” dhe “Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri”<sup>9</sup>, *përbëjnë thelbin e partneritetit dhe bashkëpunimit simbiotik të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë*, konsideruar si komponentët më të rëndësishëm të funksionimit efektiv të Trekëndëshit të Llogaridhënies Publike.



## II. KUADRI AKTUAL I KOMUNIKIMIT MES KLSH-SË DHE KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka miratuar një strategji komunikimi për periudhën 2017- 2019. Strategjia është e ndarë në 8 kapituj:

1. Një vështrim mbi situatën aktuale;

<sup>8</sup>Deklarata e Kongresit të XXI të INCOSAI-t, Pekin, Tetor 2013, “40 – Vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83, fq 219

<sup>9</sup> Kongresi XXII, INCOSAI-t, Abu Dhabi, Dhjetor 2016, “40 – Vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83, fq. 237

2. Misioni dhe vizioni- politikat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;
3. Partnerët strategjikë;
4. Botimet, revista shkencore dhe Java e Hapur si mjete komunikimi dhe llogaridhënieje;
5. Risqet e Komunikimit dhe menaxhimi i tyre;
6. Objektivat strategjikë dhe Plani i Veprimit;
7. Burimet;
8. Monitorimi i Strategjisë, kontrolli dhe raportimi.

Objektivat kryesorë të strategjisë së komunikimit të KLSH janë përcaktuar në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit :

*Objektivi Nr. 1:* Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

*Objektivi Nr. 2:* Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

*Objektivi Nr. 3:* Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinionioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

*Objektivi Nr. 4:* Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rumbullakëta.

*Objektivi Nr. 5:* Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

*Objektivi Nr. 6:* Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

Rëndësia që i jep KLSH komunikimit dhe angazhimit me aktorët e jashtëm është shprehur qartësisht, përderisa pesë nga gjashtë objektivat fokusohen në këtë lloj angazhimi.

**Në këtë udhëzues jemi fokusuar në forcimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me një prej partnerëve strategjike të KLSH-së, Kuvendin e Shqipërisë.**

Në frymën e përcaktimeve të Deklaratës së Limës dhe të orientimeve të Raportit të SIGMA-s, nr. 33 “Marrëdhëniet mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Komisioneve Parlamentare”, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e Kryetarit të KLSH-së, në Platformën Strategjike për zhvillimin e KLSH-së, paraqitur në Komisionin e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, Kryetari i KLSH-së ka theksuar se një ndër objektivat kryesore të punës së institucionit në 7 vitet e ardhshme do të ishte: *“Intensifikimi i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011- 2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues...”*

Gjashtë vite e gjysëm më parë, KLSH vinte nga një traditë raportesh formale me Kuvendin, pothuajse tërësisht të përqendruara në paraqitjen shabllone çdo vit të detyrimit kushtetues të raportimit mbi Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin pararendës dhe të raportimit mbi Performancën e KLSH. Nuk ishte e lehtë ta tejkalojë këtë mënyrë të menduarit.

Që prej vitit 2012, KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me Parlamentin duke e konturuar këtë raport në shinat e forcimit të llogaridhënies, transparencës dhe mirëqeverisjes. Në filozofinë e punës si institucion “whatchdog” i qytetarit dhe Kuvendit,

zgjodhëm qasjen e promovimit të trekëndëshit të llogaridhënies “Parlamenti(qytetarët)” - KLSH - Qeveri”, në dobi të forcimit të llogaridhënies dhe transparencës së qeverisjes. Për këtë, synuam dhe kërkua komunikim më të shpeshtë me Parlamentin, duke respektuar rregullin bazë që si institucion suprem i auditimit, si SAI, ne nuk bëjmë politika, por auditojmë zbatimin e tyre.

Vullneti për thellimin e bashkëpunimit ka qenë reciprok sepse edhe Kuvendi ka treguar një vëmendje të veçantë në raport me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kontributi i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kryetarit dhe Sekretarit të Komisionit si dhe Kryetarit të Kuvendit ka qenë thelbësor për miratimin e ligjit të ri të KLSH-së 154/2014 (datë 27/11/2014), një ligj që inkorporoi standardet e INTOSAI-t në auditimin e jashtëm në Shqipëri dhe që përforcoi pavarësinë e institucionit. KLSH dhe veçanërisht Kryetari kanë bërë përpjekje të mëdha përgjatë një viti të plotë për të bërë të mundur që ligji i ri i KLSH të miratohet nga Kuvendi në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë aspekt vlerësojmë rolin, angazhimin mbështetjen që DG Budget i Bashkimit European dhe SIGMA kanë dhënë për hartimin e Ligjit të ri Organik të KLSH-së duke mundësuar që Ligji i miratuar të reflektonte praktikën më të mira bashkëkohore të INTOSAI-t dhe të acquis komunitare të BE.

**1. Në rrafshin e komunikimit institucional dhe të detyrimeve të ndërsjella kushtetuese midis dy institucioneve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dërguar Kuvendit 38 raporte me ndjeshmëri të lartë publike gjatë 2017 dhe 2018, ndër të cilat përmendim:**

- Informacion mbi rekomandimet e KLSH-së për auditimin e Bankës së Shqipërisë;
- Raportin e Auditimit të Performancës mbi Rehabilitimin e ish-të Përndjekurve Politikë;
- Raportin e Auditimit të Performancës mbi Transportin Publik në Bashkinë Tiranë;
- Rekomandimet e KLSH-së mbi auditimin e kryer në Ministrinë e Punëve të Brendshme (ndarja administrative territoriale);
- Informacion mbi auditimin e kryer në Drejtorinë e Përgjithshme Portuale të Durrësit;
- Raportin e Auditimit “Mbi Zbatimin e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë së Veprimtarisë Ekonomike-Financiare” në OSHE, OST, KESH;
- Raportin e Auditimit të Performancës me temë “Mbrojtja e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë;
- Raportin përfundimtar si dhe rekomandimet e KLSH-së mbi auditimin e AKBN;
- Informacione, raporte, rekomandime të KLSH-së mbi auditimin në Albpetrol sh.a.;
- Raportin e Auditimit të Performancës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
- Informacion mbi integritetin e zyrtarëve të administratës shtetërore;
- Kërkesa të njëpasnjëshme për auditimin e llogarive financiare të KLSH-së, etj.
- Një trajtim të veçantë nga Kuvendi ka marrë raporti i auditimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Avokaturën e Shtetit, e njohur në media si çështja CEZ. Komisioni i Posaçëm Parlamentar, i ngritur për të hetuar zbatimin e legjislacionit shqiptar në mbrojtje të interesave të vendit gjatë marrëveshjes për zgjidhje me mirëkuptim mes CEZ dhe Republikës së Shqipërisë, ka pritur në tetor të 2016 në seancë dëgjimore kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Raporti/Vendimi i Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti dhe Vendimi i Auditimit në Drejtorinë e Thesarit (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti i Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti i auditimit "Për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në Komisionin e Prokurimit Publik (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti i auditimit "Për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në Agjencinë e Prokurimit Publik (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raport mbi Auditimin e Performancës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësor dhe Rural (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raport mbi Auditimin e Performancës të Menaxhimit të Borxhit Publik (Komisionit për Ekonominë dhe Financat);
- Raport mbi Auditimin e Performancës për Koston e Shërbimeve Spitalore (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raport mbi Auditimin e Performancës mbi Cilësinë e ndërtesave para-universitare (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti dhe Vendimi mbi Auditimin e Performancës mbi Cilësinë së Ajrit (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Ambientin, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti / Vendimi mbi Auditimin e Performancës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Nën/Kryetarëve të Kuvendit);
- Raporti dhe Vendimi mbi Auditimin e Performancës, Unifikimi i pikave doganore me Kosovën (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit për Ekonominë dhe Financat Nën/Kryetarëve të Kuvendit).

Kuvendit i kanë kaluar raportet më të rëndësishme në tematika dhe impaktin e shpresuar nga auditimi. Përqindja është më e madhe kur bëhet fjalë për raporte të auditimit të institucioneve qendrore ose raporte të auditimit të performancës. Për vitin 2018, synojmë të informojmë dhe sensibilizojmë Kuvendin dhe komisionet e tij, për rreth 30 përqind të numrit të përgjithshëm të auditiveve të realizuara.

**2. Në maj të vitit 2018 Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të KLSH-së me objekt Auditimin e performancës "Kostimi i Shërbimit Spitalor". Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e KLSH-së prezantuan dhe shpjeguan gjerësisht gjetjet, problematikat dhe rekomandimet e adresuara nga KLSH për këtë aspekt social mjaft të rëndësishëm me ndjeshmëri të lartë publike duke i mundësuar parlamentarëve të ushtrorin kompetencat institucionale ndaj organeve qeveritare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.**

3. Ne shtator të vitit 2016 u zhvillua seanca degjimore për shqyrtimin nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, të Raportit të KLSH-së për auditimin e kryer në Bankën e Shqipërisë në të cilin ishin të pranishëm titullarët e dy institucioneve.

**3. Një përmasë tjetër e promovimit dhe forcimit të komunikimit në KLSH, që ka theksuar dhe garantuar profilin profesional të institucionit, është organizimi për herë të parë i konferencave shkencore, për nxitjen e mendimit të përparuar shkencor për çështje të sotme të auditimit publik dhe të financave publike, duke përfshirë kontributet e institucioneve partnere të KLSH në rajon dhe më gjerë në Evropë, përfaqësuesve më aktivë e cilësorë të akademikëve dhe profesorit shqiptar, si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, pa anashkaluar në asnjë rast kontributin e audituesve të institucionit. Konferenca Shkencore është afirmuar si një forum i rëndësishëm për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë, përmes prezencës së theksuar të mediave, për të transmetuar tek qytetarët arritjet, sfidat, problematikat dhe idetë e reja për menaxhimin e shëndoshë të financave publike. Një tjetër tipar i rëndësishëm i Konferencave Shkencore është se mbledh në një tryezë diskutimi të gjithë palët e interesit, duke realizuar kështu një komunikim të drejtpërdrejtë dhe konstruktiv në funksion të promovimit të mirëqeverisjes. Konferenca e I-rë u zhvillua në vitin 2012 dhe ka trajtuar temën “87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar”, Konferenca e II-të me temë “Roli i SAI-t për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme” u zhvillua në dhjetor të vitit 2013 dhe Konferenca e III-të, tetor 2014 trajtoi si temë kryesore “Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare”. Me rëndësi për t’u përmendur është Konferenca e IV-të Shkencore “Analiza e Riskut”, e cila u zhvillua në qershor të vitit 2016 dhe bëri publike hartën e risqeve në sektorin publik shqiptar, me qëllim informimin e qytetarëve për zonat nevralgjike të shërbimeve publike dhe nxitjen e ndërgjegjësimit qeveritar për marrjen e masave për reduktimin e risqeve. Konferenca e V-të Shkencore u zhvillua në datat 11 -13 tetor 2017, në Tiranë dhe u realizua si një bashkëpunim mes Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gjykatës Turke të Llogarive dhe Fondacionit të Kontabilitetit për Bashkëpunim Akademik të Turqisë dhe kishte si temë kryesore “Të Auditosh për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim”.**

Kontribut të veçantë në këto konferenca shkencore kanë dhënë mesazhet e Presidentëve të Republikës (2012-2017) dhe Sekretarit të Komisionit të Ekonomisë, akademiku Prof. Dr Anastas Angjeli.

Konferenca e VI-të shkencore vjetore e KLSH-së u zhvillua në datat 9-11 prill 2018, në Kuvajt dhe ishte një bashkëpunim mes KLSH-së dhe Byrosë së Auditimit Shtetëror të Kuvajtit, së bashku me NIK-un Polak dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

#### **4. *Kuvendi i Shqipërisë-Partner strategjik i KLSH-së***

Strategjia e komunikimit të KLSH-së nuk mund të realizohet pa ndërtuar një partneritet funksional me të gjithë palët e interesuara. Ky partneritet është shpallur si prioritet strategjik i punës së institucionit.

KLSH konsideron si partnerë strategjikë kryesorë në realizimin e misionit të tij të komunikimit :

- Taksapaguesit (qytetarët shqiptarë);

- Kuvendin e Shqipërisë;
- Institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe mediat;
- SAI-t (Institucionet supreme të auditimit) homologe, anëtare të EUROSAI dhe INTOSAI-t; Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO) dhe Gjykata Europiane e Audituesve (ECA);
- Delegacionin e BE-së dhe programin SIGMA;
- Shoqatat profesionale të fushës.

Marrëdhënia KLSH - Kuvend është e natyrshme dhe nuk duhet kuptuar si diçka artificiale e protokollare. Kontrolli i Lartë i Shtetit është agjent i Parlamentit dhe i qytetarëve, për të siguruar administrimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, në bazë të Standarteve të INTOSAI-t.

Nga viti në vit, KLSH dhe Kuvendi i kanë ngritur raportet e tyre në një shkallë më të lartë duke shërbyer si aktorë kryesorë të transparencës dhe llogaridhënies, në funksion të informimit të qytetarëve mbi mënyrën sesi shpenzohen fondet publike. Pjesëmarrja e Kryetarit të Kuvendit, deputetëve dhe Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat në aktivitetet e KLSH-së si Analizat Vjetore, konferencat shkencore etj., dëshmojnë për mbështetjen parlamentare që gëzon Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet e auditimit të KLSH-së po citohen gjithnjë e më shumë në komisionet parlamentare dhe ky është një indikator i besimit në rritje të Kuvendit ndaj KLSH-së. Ky besim i Kuvendit është një inkurajim i madh për punën audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit sepse mundëson funksionimin e mekanizmave të “Trekëndëshit të Llogaridhënies” (SAI-Parlament-Ekzekutiv), pasi i projekton gjetjet dhe rekomandimet e auditimit pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, duke përforcuar kështu mirëqeverisjen.

Raportet kryesore drejtuar Kuvendit, ai i realizimit të Buxhetit Faktik të Shtetit për vitin paraardhës dhe raporti i performancës së KLSH, në rolin e institucionit si agjent i Kuvendit për mirëmenaxhimin e parasë publike, njohën thellësinë e argumentit dhe gjetjes audituese, dobinë e plotë të rekomandimeve në përmirësim konkret të menaxhimit të fondeve publike, sipas orientimeve të standardeve ISSAI. Në funksion të rritjes së transparencës së punës së KLSH-së të gjitha Raportet e Performancës së institucionet që nga viti 2012 e në vijimësi janë pjesë e botimeve të Kolanës së KLSH-së dhe janë botuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Qysh në nëntor të vitit 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dhënë rëndësinë e duhur institucionalizimit të marrëdhënieve mes SAI-ve dhe parlamentit. Kryetari i KLSH-së ka marrë pjesë në këtë periudhë në Konferencën mbi Marrëdhëniet e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve Kombëtare të vendeve të rajonit, e cila u zhvillua në Budva, Mal të Zi. Objektivi i kësaj Konference ishte ndarja e përvojave, ndërtimi i marrëdhënieve konstruktive ndërmjet SAI-ve dhe parlamenteve, ku u diskutuan faktorët që ndikojnë në këto marrëdhënie, si dhe u hodh ideja e ndërtimit të një pakete me instrumente që mund të përdoren nga SAI-t dhe parlamentet kombëtare për të forcuar bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë. Aktiviteti u mbyll me një rezolutë të përbashkët, promotori i së cilës ishte Kryetari i KLSH-së.

Në vitin 2016, bashkëpunimi KLSH-Parlament ka fituar edhe një njohje të rëndësishme ndërkombëtare. Në datën 8-9 nëntor në Ankara të Turqisë u zhvillua Konferenca e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate, vendeve potencialisht kandidate të BE-së dhe Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA) me temë “Zhvillimi i marrëdhënieve efektive ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve”, organizuar nga

Programi SIGMA, një iniciativë e BE-së dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Gjykatën e Llogarive të Turqisë. Në konferencë morën pjesë SAI-t e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Turqisë, Bosnjë-Hercegovinës, Serbisë, Malit të Zi, si dhe përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve, Komisionit European dhe SIGMA-s. KLSH u përfaqësua nga Kryetari ndërsa Parlamenti nga një deputet, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Konferenca theksoi se puna e një SAI është punë integrale e vetë Parlamentit, e parë kjo në këndvështrimin e formulës se “SAI është agjent i Parlamentit”. Si e tillë, ndjekja e rekomandimeve shtron detyra edhe për vetë Parlamentin. Për këtë arsye projektimi i rekomandimeve nga vetë Parlamenti e adreson punën audituese drejt transparencës dhe llogaridhënies, duke përmirësuar kështu menaxhimin e fondeve publike. Prezenca e deputetëve në këtë konferencë, së bashku me delegacionin e KLSH-së, është një dëshmi e marrëdhënieve pozitive që ekzistojnë mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë.

Me vullnetin dhe dëshirën e përmbushjes së detyrimeve të Kuvendit, Kryetari i KLSH-së ka nxjerrë urdhrin nr.122, datë 23 qershor 2017, “Për përmbushjen e detyrimeve të KLSH-së ndaj Kuvendit të Shqipërisë”, nëpërmjet të cilit specifikohen qartazi detyrimet e strukturave të KLSH-së lidhur me hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, dërgimin çdo 6 muaj të një informacioni në Kuvend lidhur me progresin e bërë në drejtim të implementimit të rezolutës për vitin paraardhës dhe në statusin e implementimit të rekomandimeve, etj.

a) Mbi krijimin e nën-komisionit parlamentar dedikuar veprimtarisë së KLSH-së.

Viti 2016 njohu një moment tepër të rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve KLSH-Parlament sipas standardeve më të mira europiane. Kuvendi miratoi Rezolutën për Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015. Kjo rezolutë shpreh angazhimin maksimal të Kuvendit me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit si dhe mundësinë e krijimit të Nënkomisionit parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe veçanërisht zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga institucionet e shtetit.

Ekzistenca e një komisioni të “profilizuar” për auditimet e KLSH-së do të mundësojë një komunikim të vazhdueshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Kuvendin, duke i mundësuar qytetarit një njohje më të mirë mbi mënyrën se si shpenzohen fondet publike. Në këtë prizëm, rekomandimet e KLSH-së do të shërbejnë jo vetëm për efekt rregullues e zhdëmtues, por edhe si “input” që Parlamenti mund t’i përdorë në hartimin e politikave buxhetore.

Për të gjitha detyrat e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Kontrolli i Lartë të Shtetit ka hartuar në çdo rast plane konkrete pune për zbatimin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit, si Institucioni më i lartë i kontrollit Ekonomiko- Financiar në vend, njëherazi është agjent i Kuvendit për të siguruar mirë-administrimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve publike, në bazë të Standardeve të INTOSAI-t. KLSH e zbaton këtë mision dhe detyrë parësore, duke i raportuar Kuvendit sipas përcaktimeve kushtetuese, si dhe duke zbatuar çdo rekomandim dhe orientim të Kuvendit. Janë këto arsytet që institucioni i ka konsideruar në vitet e fundit Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si programe të qarta pune për të. Këto rekomandime janë përfshirë natyrshëm në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH.

Në Rezolutën e Kuvendit të datës datë 20 tetor 2016, “Mbi performancën e Kontrollit të Lartë i Shtetit të vitit 2015 “ theksohet që:

*“Kuvendi i Shqipërisë, në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese,por dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres raportit 2015 për ngritjen e një mekanizmi më efikas nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim,*

*me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së sa më poshtë:*

*- Të bashkëpunojë me KLSH-në dhe Qeverinë, që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;*

*- Të shikojë mundësinë e krijimit të Nënkomisionit Parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve”.*

KLSH në planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës adresuar Kuvendit në datë 25 tetor 2016 u shpreh zyrtarisht që do të intensifikojë marrëdhëniet me Parlamentin si dhe inkurajon krijimin e Nënkomisionit Parlamentar i dedikuar për veprimtarinë e KLSH-së, brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat konsideruar, si një mekanizëm mjaft efikas për realizimin e mbikëqyrjes parlamentare por edhe njëherazi si një institucionalizim i praktikave më të mira në Komunitetin e INTOSAI-t.

Në këtë kuadër në datën 4 qershor 2018, në Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe SIGMA – një iniciativë e OSCE, financuar kryesisht nga BE organizuan takimin “Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të punës ndërmjet KLSH-së dhe Parlamentit” si dhe prezantimin për palët e interesit të Strategjisë për Zhvillim të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2018 -2022.

I organizuar mbi bazën e Dokumentit të SIGMA nr.54 “Zhvillimi i Marrëdhënieve efektive të punës ndërmjet SAI dhe Parlamenteve”, ky takim ofroi mundësi për të diskutuar se si krijohen dhe ruhen marrëdhënie bashkëpunimi mes institucioneve të larta të auditimit dhe parlamenteve për t’u dhënë mundësi parlamenteve që t’i vënë qeveritë përpara përgjegjësisë dhe për t’i ndihmuar institucionet e larta të auditimit të kenë më shumë ndikim me punën e tyre audituese.

Si një çështje me mjaft rëndësi, takimi mbledhi së bashku rreth 60 pjesëmarrës. Takimin e nderoi me prezencën e tij, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z.Gramoz Ruci, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë, Këshilltarë të Lartë të SIGMA, përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Tiranë, përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të pavarura, të organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarë për të diskutuar mbi një nga elementët kyç marrëdhëniet, SAI-Parlament.

Zoti Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë në fjalën e tij vlerësoi faktin pozitiv që Kuvendi dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit kanë bashkëpunuar si partnerë. Komisionet parlamentare dhe deputetët i kanë shfrytëzuar dhe janë mbështetur në indiciet nga auditimet e KLSH në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale për kontrollin parlamentar, si edhe në angazhimin për të qenë konkret e aktiv në luftën kundër korrupsionit, abuzimeve dhe defekteve të tjera të qeverisjes. Kuvendi po punon paralelisht për fuqizimin e rolit të tij ligjberës e kontrollues për të dyja funksionet, një shërbim të madh praktik japin edhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fuqizimi i të dy funksioneve të Kuvendit do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e punës së ekzekutivit, nëpërmjet llogaridhënies e transparencës, si dy parime themelore të mirë-qeverisjes. Kjo do të garantojë që fondet publike të shkojnë në përfitim të publikut e qytetarit, duke garantuar shërbime publike efektive, cilësore dhe të përballeshme për të gjithë.

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe rekomandimeve të Progres-raportit të Komisionit Europian, në vitin 2017 Kuvendi, me një vendim të veçantë, krijoi mekanizmin ndërinstitutional Kuvend-Qeveri-Institucione të Pavarura, si një instrument efikas për



monitorimin sistematik të ndjekjes e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura ndaj ekzekutivit. Praktikën e deritanishme të drejtuar kryesisht në dy raportimet vjetore të KLSH do të plotësohen nga instrumente të tjerë të kontrollit parlamentar, të tilla si dëgjuesat, seancat e pyetjeve në komisionin përgjegjës të ekonomisë e financave dhe komisione të tjera, si edhe ngritja e komisioneve të posaçme hetimore. Pra, rekomandimet e Kontrollit të Shtetit do të kalojnë përmes një procesi diskutimesh e debatesh midis Kuvendit, KLSH si institucion rekomandues dhe institucioneve të tjera e grupeve të interesit. Kjo do të mbështetet dhe përnismat ligjvënëse të propozuara nga KLSH, të cilat do të finalizohen nëpërmjet një konsultimi të gjerë publik. Kjo do të mundësojë që gjetjet e auditimeve dhe rekomandimet e auditimit të kalojnë nëpërmjet një procesi të gjerë shqyrtimi, sensibilizimi e llogaridhënieje. Në këtë mënyrë, rekomandimet apo propozimet për penalizime ndaj shkeljeve e shkelësve të ligjit nuk do ta kenë të lehtë të fshihen apo zvarriten pas teknikaliteteve e justifikimeve të burokratëve përgjegjës.

Ne funksion sa me sipër Kuvendi ka miratuar Vendimin nr. 49/2017 *“Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”*.

Në fund të fjalës së tij, Kryetari i Kuvendit zoti Ruçi theksoi: *“Kuvendi po mbështetet gjithnjë e më shumë në indiciet dhe gjetjet e institucionit suprem të auditimit në vend. Rezoluta e Kuvendit e tetorit 2016 për Kontrollin e Lartë të Shtetit ka rritur pritshmëritë e Kuvendit që auditimet tuaja të dalin më analitike dhe cilësore. Ju jeni gardiane të ligjshmërisë, ndershmërisë dhe eficiencës së aktivitetit qeveritar. Do të marr masa që brenda këtij sesioni legjislativ të mundësojmë krijimin e nën-komisionit të posaçëm për shqyrtimin e raporteve të auditimit të KLSH-së”*.

KLSH është në pritje të krijimit të këtij nën-komisioni dhe shpreh bindjen që ky organizëm do të institucionalizojë bashkëpunimin dhe koordinimin efektiv për funksionalitetin e partneritetit midis tre komponentëve të “Trekëndëshit të Llogaridhënieje” (Parlament, KLSH, Qeveria).

Krijimi i këtij nënkomisioni është një nevojë imediate dhe domosdoshmëri dhe në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve adresuar nga Komisioni Europian në kuadër të Progres Raportit Prill 2018. Në këtë aspekt KLSH do të angazhohet maksimalisht dhe do të jetë kontributor aktiv dhe do të përmbushë dhe mbështesë çdo inisiativë të ndërmarrë nga Parlamenti, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, si dhe nga Qeveria, pasi efektiviteti i auditimeve të KLSH-së arrihet vetëm nëpërmjet zbatimit të rekomandimeve nga entitetet publike dhe është e vetmja mënyrë, përmes së cilës KLSH si institucion i auditimit të jashtëm publik mund të kontribuojë efektivisht në mirëqeverisjen dhe mirë administrimin e ekonomisë, financave dhe pronës shtetërore.

Zoti Leskaj propozoi nënshkrimin e një marrëveshjeje kuadër bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, për të cilën z. Ruci shprehu dakortësinë që do të nënshkruhet brenda vitit 2018.

Si KLSH, si SAI, në bazë të standardeve të INTOSAI-t, të Rezolutave të OKB-së dhe të Raporteve të SIGMA-s, gjykojmë se marrëveshja duhet të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, si plotësim edhe të rekomandimit të njëjtë (forcimi i ndjekjes parlamentare) të dhënë nga Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë në tre vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018, por edhe një axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimit qendror të KLSH-së në këto vite, për draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, si dhe

angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhërit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve në varësi të saj.

### III. INSTRUMENTET E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME PARLAMENTIN

KLSH si Institucioni më i lartë i auditimit në vend vepron *si agjent i Kuvendit* dhe jep atij sigurinë e nevojshme në cilësinë e institucionit të perfaqësimit të qytetarëve mbi përdorimin e fondeve publike nga ekzekutivi, duke luajtur në këtë mënyrë një rol të pazëvendësueshëm për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës.

Parimet themeluese për punën e Institucioneve Supreme të Auditimit të përfshira në ISSAI 1 (Deklarata e Limës) dhe parakushtet për pavarësinë e Institucionit Suprem të Auditimit në ISSAI 10 (Deklarata e Meksikos për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit) përcaktojnë pritshmëritë/kërkesat themelore për Institucionet Supreme të Auditimit lidhur me zhvillimin e marrëdhënieve efektive me parlamentin.

#### 1-Raportimi në Parlament –Themeli i marrëdhënieve me Parlamentin

KLSH kryen Raportimin në Parlament bazuar në kërkesat e Kushtetutës dhe Ligjit Organik si dhe bazuar në kërkesat e Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI dhe konkretisht të ISSAI 1, ISSAI 10, ISSAI 12 dhe ISSAI 20.

ISSAI 1 – Deklarata e Limës, në nenin 16 përcakton që: “Sipas Kushtetutës, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të raportojnë gjetjet nga auditimet në Parlament, ose në një tjetër organ publik përgjegjës, çdo vit dhe në mënyrë të pavarur”.

Po kështu dhe nënparimi 15.8 i dokumentit Parimet e Administratës Publike SIGMA-BE referuar kapitullit 32 të *acquis* komunitare përcaktojnë pritshmëritë themelore të marrëdhënjes së një Institucioni Suprem Auditimi me Parlamentin “Kushtetuta autorizon dhe i kërkon Institucionit Suprem të Auditimit që të raportojë gjetjet e tij cdo vit dhe në mënyrë të pavarur në Kuvend apo cdo organi tjetër kompetent pulik dhe ky raport publikohet.”<sup>10</sup>

Në referencë të neneve 162 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Në përmbushje të këtij detyrimi dhe në referencë të nenit 164 Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:

- a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;
- b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
- c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi.

<sup>10</sup> PEFA 2016, Kuadri për vlerësimin e menaxhimit të financave publike, Sekretariati i PEFA-s, Ushangton.<https://pefa.org/>

d)Raport për veprimtarinë vjetore të KLSH-se brenda muajit Mars të vitit paardhës.

Raportimet që KLSH bën në Kuvend në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore janë momente kyç për të tërhequr vëmendjen e aktorëve të tjerë në çështje të llogaridhënies dhe luftës ndaj korrupsionit.

KLSH në funksion të maksimizimit pritshmërive institucionale i Raporton Parlamentit duke përmbushur kërkesat si më poshtë:

1.Raportimi në Parlament dhe publikimi i menjëherhëm i raporteve<sup>11</sup>.

2.Në funksion të lehtësimit të aksesit të palëve të interesit dhe të lexuarit dhe të kuptuarit të raporteve, KLSH do të përdorë mjetet e përshtatshme të komunikimit <sup>12</sup>që janë:

i) paraqitja e raporteve në Parlament në dy formate(versione) të shkurtuar në formën e një përmbledhje ekzekutive dhe raportin e plotë. Duke disponuar raportet në formate të ndryshme, kjo do të ndihmonte audiencat të kuptonin më lehtë përmbajtjen e tij sipas nevojave që kanë. KLSH aplikon Metodologjinë e të dhënave të hapura dhe info-grafikët, të cilat janë mjete shumë të mira për ta lehtësuar leximin e raportit për një audiencë të gjerë.

3.Dërgimi i raporteve në Kuvend në kohë, sipas afateve ligjore të përcaktuara.

4.Raportet e auditimit të cilat i dërgohen Parlamentit duhet të përmbajnë gjetjet, tendencat, shkaqet dhe rekomandimet, të cilat duhet të jenë diskutuar më parë me palët kryesore të interesuara.

#### **- Përcaktimi i raportimit efektiv në Parlament**

Për të matur efektivitetin e raportimit KLSH përdor disa tregues:

- Numri i raportimeve mediatike për raportin e KLSH-së;
- Numri i talk-show-ve me tema nga raporti i KLSH-së;
- Numri i diskutimeve të deputetëve rreth raportit të KLSH-së;
- Numri i OSHC-ve që kanë marrë dijeni për raportin e KLSH-së;
- Numri i qytetarëve që janë të informuar rreth raportit ( që kanë shkarkuar dokumentin nga faqja e internetit, që kanë reaguuar në rrjetet sociale, që i kanë shkruar dhe kërkuar spjegime KLSH-së për raporte të vecanta, numri i qytetarëve që kanë vizituar institucionin gjatë muajit të hapur, etj).

## **2. Komunikimi – Të kuptuarit e Rolit dhe veprimtarisë së KLSH-së.**

---

<sup>11</sup> ISSAI 10, "Institucionet Supreme të Auditimit i dorëzojnë raportet e tyre në parlament, në një prej komisioneve të tij, ose në bordin drejtues të të audituarit, sipas rastit.

<sup>12</sup> ISSAI 20, Parimi 7 përcakton se Institucionet Supreme të Auditimit raportojnë publikisht mbi rezultatet e auditimeve të tyre dhe për konkluzionet e tyre në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të qeverisë.

Duke u bazuar në pritshmëritë themelore të përcaktuara në deklaratat e Limës dhe Meksikos, ISSAI-t shprehin pritshmërinë që Institucioni Suprem i Auditimit do të zhvillojë linjat e komunikimit dhe marrëdhëniet efektive me parlamentin dhe komisionet e tij mbikëqyrëse përkatëse. ISSAI 12 përcakton se se "*Institucionet Supreme të Auditimit duhet të zhvillojnë marrëdhënie profesionale me komisionet përkatëse të mbikëqyrjes legjislative dhe bordet drejtuese dhe menaxhuese të subjekteve të audituara për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të marrin masat e duhura.*"

Ndërsa ISSAI 20 përcakton se: "*Institucionet Supreme të Auditimit mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ato të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe për të marrë masat e duhura.*"

Sa më sipër KLSH në drejtim të komponentit të komunikimit me qëllim që Parlamenti të kuptojë qartësisht rolin dhe funksionin e institucionit KLSH:

1-Do të vijojë të zhvillojë një strategji efektive komunikimi të jetë proaktiv në angazhimin dhe prezantimin e veprimtarisë institucionale me qëllim që të marrë siguri që performanca e KLSH-së mund të ketë ndikim dhe të mbështesë qeverisjen e mirë.

2. Konsolidimi i marrëdhënjeve të mira të veprimtarisë së dy institucioneve të politikave efektive të komunikimit dhe procedurave në funksion të bashkëpunimit me parlamentin.

3. Angazhimi me Parlamentin dhe Komisionet e tij si dhe rritja e ndërgjegjësimit për rolin e KLSH-së duke ofruar dhe zhvilluar trajnime për anëtarët e parlamentit për çështje nevralgjike të sektoreve të ekonomisë sikurse janë çështjet e menaxhimit të financave publike, menaxhimit të borxhit publik, duke organizuar takime jo formale me anëtarët e komisioneve parlamentare për të shpjeguar rolin dhe mandatin e KLSH-së dhe për të marrë e identifikuar regjime të ndryshme për nevojat e komisioneve të ndryshme parlamentare.

4. Ofrimi i konsulencave dhe trajnimeve se si mund të përdorin gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e KLSH-së që nën autoritetin dhe kompetencën Parlamentare të rrisin ndikimin në drejtim të rritjes së llogaridhënjes nga ekzekutivi.

Në drejtim të komunikimit në funksion të garantimit që veprimtaria e KLSH-së është e rëndësishme për parlamentin, qytetarët dhe aktorët e tjerë KLSH angazhohet :

- Të rrisë ndërgjegjësimin për pritshmëritë e palëve të interesuara dhe reagimi ndaj tyre;
- Të ndërmarë veprimtari audituese për çështjet kryesore që prekin shoqërinë;
- Të vlerësojë risqet në mjedisin e auditimit dhe reagimi ndaj tyre në kohën e duhur;
- Të garantojë pritshmëritë e palëve të interesuara dhe risqet e reja të përfshihen në planet strategjike, të biznesit dhe të auditimit, sipas rastit;
- Ndërrmarja e proceseve vlerësuese, nëse palët e interesuara besojnë se KLSH është institucion efektiv që kontribuon në ndryshimin e jetës së qytetarëve dhe në përmirësimin e sektorit publik.

-Të vlerësojë periodikisht nëse palët e interesuara perceptojnë që KLSH komunikon në mënyrë efektive

### **Ndjekja e rekomandimeve të KLSH-së**

Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 10,12 dhe 20 parashikojnë që Institucioni Suprem i Auditimit do të raportojë në parlament (dhe tek palët e tjera të interesuara) mbi rezultatet e punës së tij për të vlerësuar nëse qeveria apo entet e saj i kanë marrë apo jo masat e duhura ndaj rekomandimeve të Institucionit Suprem të Auditimit.

-Fokusuar në sa më sipër KLSH do të vijojë që:

1. Të garantojë dhe të sigurojë që raportet dhe rekomandimet të jenë tërësisht të paanshme, objektive, profesionale, të realizueshme dhe që nuk çënojnë parimet e konfidencialitetit dhe të transparencës;
2. Të ndjekë dhe të raportojë në mënyrë periodike në Parlament lidhur me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna ndaj subjekteve si dhe të synojë implementimin në kohë të rekomandimeve të parlamentit për performancën e KLSH.
3. Të publikojë Raportin e Konsoliduar të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dërguar në Kuvend.

#### **IV. HAPAT PËR INSTITUCIONALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE TË KLSH ME PARLAMENTIN**

1-KLSH do të vijojë të adresojë kerkesen dhe zyrtarisht për nënshkrimin me Parlamentin të një **Marrëveshje të gjërë kuadër**, e cila të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, por edhe një axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimeve kryesore të KLSH-së në këto vite, për draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, për kufirin e borxhit publik, si dhe angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhërit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve në varësi të saj.

2- KLSH do të vijojë të adresojë kontributin konkret në fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së duke ofruar bashkëpunim dhe komunikim intensiv me Kuvendin dhe vecanërisht me **Nënkomisionin Parlamentar të dedikuar për shqyrtimin e veprimtarisë së KLSH-së i cili referuar dhe rekomandimeve të BE-së do të krijohet së shpejti**.

3-Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis KLSH dhe Parlamentit do të përcaktohen qartë elementët teknikë dhe organizativë të bashkëpunimit mes KLSH dhe nën komisionit për auditimin e jashtëm publik, duke përfshirë llojet e raporteve të auditimit, të cilat paraqiten nga KLSH në Parlament.

4-Bazuar në raportet periodike të nënkomisionit për auditimin e jashtëm publik, KLSH do ti sugjerojë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të zhvillojë sesione të dëgjësave të përfaqësuesve të subjektit të audituar lidhur me implementimin e rekomandimeve.

5-Bazuar në raportet e përcjella nënkomisionit për auditimin e jashtëm publik dhe raportit vjetor të performancës, KLSH do i rekomandojë Komisionit për Ekonominë dhe Financat që përveç rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit të hartojë dhe përcjellë pranë Këshillit të Ministrave dhe një rezolutë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

6-KLSH ka përcaktuar Drejtorinë e Komunikimit Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë si strukturën përgjegjëse e cila mban marrëdhënie të vazhdueshme me nënkomisionin për auditimin e jashtëm publik si dhe me administratën e Kuvendit. Kjo strukturë do të jetë përgjegjëse për koordinimin e marrëdhënieve të zgjeruara që lindin nga kjo marrëveshje. Në këtë aspekt KLSH do të ofrojë bashkëpunimin me Komisionin për Ekonominë dhe Financave në caktimin e një audituesi kompetent për të bashkëpunuar me sekretariatën e nën komisionit të ardhshëm.

7-Përveç marrëdhënies me Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe nën komisionin e tij, KLSH në kuadër të marrëveshjes me parlamentin, do të mbajë marrëdhënie të rregullta me komisionet e tjera parlamentare, të cilat mund të jenë të interesuar për raporte të veçanta auditimi. Në këtë aspekt KLSH-së do të marrë në konsideratë takime të rregullta me parlamentarë për të diskutuar rekomandimet e auditimeve me interes të posaçëm. Këto takime do të mundësojnë një informacion më të qartë të nevojave të komisioneve parlamentare, sfidat kryesore dhe risqe me të cilat ballafaqohen subjektet e audituara. KLSH

do të vazhdojë organizimin e konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta për çështje të veçanta, në të cilat do të ftohen deputetët e parlamentit.

8-KLSH do të përdorë produktet e punimeve të Parlamentit për iniciimin e auditimeve të veçanta me interes të lartë publik, si dhe të marrë konsideratë propozimet e ardhura nga Kuvendi për iniciimin e një auditimi në një fushë me interes për Kuvendin e Shqipërisë duke bërë më parë analizën e riskut. Në këtë kuadër KLSH përpra hartimit të planit vjetor të veprimtarisë audituese do të adresojë Kuvendit kërkesën për propozimet e mundshme që mund të ketë Kuvendi për të realizuar auditime në institucionet publike.

9-Për të maksimizuar punën, KLSH angazhohet që në varësi të kërkesave të ardhura nga parlamentarë, të paktën një herë në vit të zhvillojë tryezën e rrumbullakët për deputetët me qëllim një informim më të mirë për punën e tij.

KLSH përgjatë këtyre aktiviteteve do të sjellë në vëmendje të anëtarëve të komisioneve parlamentare auditimet e rëndësishme me impakt për ekonominë dhe jetën e qytetarëve për të cilat rekomandimet korigjuese të KLSH nuk janë marrë në konsideratë ose janë marrë pjesërisht në konsideratë nga ekzekutivi. Tryeza e rrumbullakët do t'i shërbejë dhe diskutimit dhe përthithjeve të ideve për përzgjedhjen e temave dhe subjekteve të auditimit për vitin pasardhës.

\* \* \*

Investimi kryesor i së ardhmes për KLSH-në është forcimi i besimit të qytetarëve dhe Parlamentit në rolin dhe vlerën e shtuar të punës së tij.

Si auditues të KLSH, si trupë auditimi që synon të shndërrohet në një formacion auditues modern evropian, garantojmë se do të kushtojmë të gjitha kapacitetet dhe energjitë tona në realizimin e këtij investimi madhor, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e institucionit, duke prodhuar raporte cilësorë auditimi, duke forcuar llogaridhënien dhe përmirësuar qeverisjen.

Shënim: Ky dokument i përcillet Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim që përgjatë muajit Korrik 2018, të mundësohet marrja e sugjerimeve nga ana e Deputeteve si dhe reflektimi në të, i kërkesave të Rezolutës që do të miratojë Kuvendi për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2018 në datë 19 Korrik 2018.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

ZËVENDËSKRYETARE

Valentina LESKAJ



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË  
TË SHTETIT PËR VITIN 2015

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke njohur dhe vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni kushtetues i pavarur i kontrollit të jashtëm ekonomiko-financiar, që auditon procedurat dhe zbatimin e ligjeve që rregullojnë menaxhimin me efikasitet dhe dobishmëri të fondeve dhe pronës publike e shtetërore;

- Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

- Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë, nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI;

- Duke pranuar se përmbushja e prioriteteve dhe objektivave të procesit të integritetit në Bashkimin Europian, kërkon standarde më të larta dhe rezultate më të qëndrueshme e në rritje progresive, në funksion të përmirësimit të shtetit ligjor përmes koordinimit të punës me strukturat e tjera shtetërore dhe atyre të pavarura që ushtrojnë veprimtari në fushën e mbikëqyrjes dhe të zbatimit të ligjit në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së;

- Duke besuar se analiza vjetore e veprimtarisë së këtij institucioni, në funksion të ushtrimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit, i shërben vlerësimit të arritjeve dhe evidentimit të mangësive, si dhe administrimit sa më të mirë të burimeve të veta njerëzore dhe financiare, me qëllim realizimin e objektivave, në përputhje me Planin Strategjik 2015-2017 dhe Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së;



- Duke vlerësuar angazhimet për zbatimin e ligjit organik nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

**Pas analizës, shqyrtimit dhe diskutimit të raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

● Në drejtim të kuadrit ligjor, KLSH-ja gjatë vitit 2015:

- Ka zhvilluar veprimtarinë e saj në bazë të një kuadri të ri ligjor dhe të përputhur me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit;

- Me miratimin e ligjit të ri organik, u angazhua tërësisht për hartimin e kuadrit rregullator të menaxhimit institucional e metodologjik dhe orientoi veprimtarinë drejt modernizimit dhe reformimit institucional;

- Me ligjin e ri siguroi një platformë solide për vijueshmërinë në të ardhmen të veprimtarisë së saj, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI), si dhe u përball me sfida institucionale për të implementuar ISSAI-n;

● Në drejtim të veprimtarisë audituese, KLSH-ja gjatë vitit 2015:

- Ka planifikuar dhe realizuar pothuajse një numër të njëjtë auditimesh, krahasuar me vitin 2014;

- Ka evaduar gjithsej 158 nga 174 auditime të kryera, nga ku vërehet trend rritës në auditimet e performancës, si dhe kryerja për herë të parë e auditimit në teknologjinë e informacionit, si dhe dhënies së opinionit për pasqyrat financiare;

- Ka realizuar dhe evaduar 12 auditime performance, ku ka ardhur duke u rritur numri i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, si dhe numri i subjekteve të përfshira;

- Ka ushtruar veprimtarinë audituese në 211 institucione, sipas niveleve të administrimit shtetëror, administratës fiskale dhe shoqërive me kapital shtetëror;

- Ka zbuluar një shumë totale të dëmit efektiv të përgjithshëm për parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera në vlerën 125,76 miliardë lekë. Këto shkelje financiare i përkasin veprimtarisë ekonomike-financiare për periudhën kohore 2008-2015;

- Ka rekomanduar për zhdëmtim 46,7 për qind të totalit të shkeljeve financiare;

- Ka pasur rritje të indikatorit të dobisë së rezultateve të auditimit, ku rezulton se për çdo një lek të shpenzuar nga Buxheti i Shtetit, nga ana e KLSH-së, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 180,1 lekë;

- Ka pasur pothuajse të njëjtin trend me atë të vitit 2014 në rekomandimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2015. Në total janë 4100 rekomandime që përfshijnë masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore;

- Ka pasur ulje të indikatorit të performancës në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve për të gjitha kategoritë;

- Ka rekomanduar për ndryshime legjislative në 35 raste, me spektër të gjerë, që përfshijnë amendime kushtetuese, ndryshime të ligjeve bazë, si dhe ndryshime të vendimeve të Këshillit të Ministrave apo dhe akte të tjera rregullative;

- Ka kryer kallëzimet penale, në kuadër të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes. Për 2015 KLSH i ka adresuar organit të Prokurorisë 51 kallëzime penale për 159 zyrtarë.

● Në drejtim të menaxhimit institucional, KLSH-ja gjatë vitit 2015:

- Ka vijuar reformimin institucional,

me strukturën e re organizative, e cila është përshtatur me ligjin e ri, si dhe me objektivat strategjikë të institucionit;

me hartimin e akteve dhe udhëzimeve të domosdoshme, në kuadër të zbatimit të ligjit, strategjisë së zhvillimit institucional dhe implementimit të standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare;

me forcimin e kapaciteteve audituese dhe zhvillimin e burimeve njerëzore përmes trajnimeve profesionale brenda dhe jashtë vendit;

- Ka rritur transparencën institucionale, duke vijuar komunikimin dhe bashkëpunimin me palët e interesuara, publikun, median, publikimet, si dhe ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në veprimtari shkencore;

- Ka analizuar veprimtarinë administrative të KLSH-së nëpërmjet analizës SWOT, e cila garanton zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit;

- Ka zhvilluar më tej marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë INTOSAI dhe EUROSAI. Në kuadër të projekteve IPA, KLSH-ja ka filluar të zbatojë projektin IPA "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm" me vlerë 2,8 milion euro;

- Në kuadër të bashkëpunimit institucional me Kuvendin e Shqipërisë, marrëdhëniet kanë qenë bashkëpunuese, me raportime dhe informacione të raporteve zyrtare për komisionet e Kuvendit, si dhe në implementimin e ligjit të hyrë në fuqi në muajin shkurt të vitit 2015.

• Raporti shoqërohet edhe me raportin e auditimit të brendshëm dhe zbatimin e buxhetit për KLSH.

**Për vitin 2016 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2017, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Kontrolli i Lartë i Shtetit fokusimin, në mënyrë të veçantë në këto drejtime:**

1. Të vijojë implementimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, duke konsideruar që ligji i ri, riorganizimi i ri strukturor, si dhe format e reja bashkëkohore të auditimit dhe analizës duhet të vihen në shërbim të zgjidhjes konstruktive të problematikave të vërejtura gjatë vitit 2015.

2. Pavarësisht përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullativ, prioritet në vijimësi duhet të jetë implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit, studimi i kujdesshëm dhe integral i ISSAI-eve, interpretimi i tyre brenda kontekstit shqiptar të auditimit të aktivitetit ekonomik publik, si edhe aksesit të kufizuar në informacion që shpeshherë ofrojnë subjektet nën auditim.

3. Në drejtim të veprimtarisë audituese, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vijojë me rritjen e cilësisë dhe konsolidimin e mëtejshëm të auditimeve të ligjshmërisë e përputhshmërisë, të teknologjisë së informacionit, dhe veçanërisht në auditimet e performancës.

4. KLSH-ja në vijimësi duhet të konsolidojë kryerjen e auditimeve financiare (certifikimin e pasqyrave financiare) të qeverisjes së përgjithshme deri në arritjen e objektivit final të dhënies së opinionit për pasqyrat financiare të gjithë Qeverisë.

5. KLSH-ja nxitet që për 3 vjet të auditojë të gjitha privatizimet dhe kontratat koncensionare të realizuara në sektorët strategjikë në 25 vitet e fundit, për të vlerësuar ligjshmërinë, efektivitetin dhe ndikimin e tyre në Buxhetin e Shtetit dhe te publiku.

6. KLSH-ja të vijojë me përmbushjen e objektivave për rritjen e kapaciteteve audituese të burimeve njerëzore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, duke përqasur metodologji moderne për auditim, për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe rekomandimeve të dhëna nga kjo rezolutë.

7. KLSH-ja gjatë vitit 2016 e në vijim të zbatojë strategjinë e menaxhimit të kontrollit të riskut, me qëllim identifikimin, analizimin dhe monitorimin e risqeve kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e KLSH-së në funksion të minimizimit të ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive gjatë veprimtarisë audituese.

8. KLSH-ja, në zbatim të kërkesave të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit, duhet të rrisë adresimin e rekomandimeve në sektorë me impakt në publik, duke synuar që të

jenë vlerë e shtuar në mirëqenien qytetare, si dhe të kërkojë ndjekjen e zbatimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme.

9. KLSH-ja të fuqizojë procesin e kontrollit të sigurimit të cilësisë, në zbatim të ISSAI-40 si një proces, i cili synon të garantojë shqyrtimin dhe analizën e brendshme të çdo procesi auditimi, në përfundim të procedurave të shqyrtimit të rekomandimeve nga institucioni i audituar dhe të marrjes së vendimeve përkatëse. Analiza duhet të fokusohet në trajtimin e argumenteve dhe sidomos referencave ligjore të përdorura nga personat përgjegjës, të cilët brenda institucionit të audituar, kanë përgjegjësinë e shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve në lidhje me rekomandimet.

10. KLSH-ja duhet të angazhohet për të rritur bashkëpunimin institucional me Prokurorinë e Përgjithshme, nëpërmjet monitorimit të ecurisë së padive penale dhe të zhvillojë një analizë fundore të saj në rastet e pushimit të çështjeve ose mosfillimit të çështjeve të referuara nga KLSH-ja në organin e akuzës. Kjo do të shërbejë për të kryer një analizë përfundimtare më të plotë, si dhe kontrollin e cilësisë së vetë raporteve të auditimit.

11. KLSH-ja, duke filluar nga viti i ardhshëm e në vijim, duhet të bëjë pjesë integrale të raportit vjetor që paraqitet në Kuvend, edhe një raport që përfshin shkallën dhe mënyrën e zbatimit të rekomandimeve, si dhe një raport mbi kontrollin e sigurimit të cilësisë së veprimtarisë audituese.

12. KLSH-ja, duke filluar nga viti i ardhshëm, të bëjë pjesë integrale të raportit vjetor të performancës së KLSH-së, analizën e shkallës së evadimit dhe zbatimit të rekomandimeve që kanë në përmbajtje të tyre masa zhdëmtimi.

13. KLSH-ja, në kuadër të bashkëpunimit institucional, për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit dhe në funksion të miradministrimit të fondeve dhe pasurive publike, duhet të rishikojë marrëveshjet/memorandumet e bashkëpunimit me institucionet dhe organet ligjzbatuese, për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërkesave të kohës.

14. KLSH-ja të vijojë përqendrimin e punës së vet në intensifikimin e procesit auditues për të parandaluar, zbuluar dhe denoncuar aktet korruptive, në funksion të forcimit të kulturës së ndëshkueshmërisë dhe të mirëqeverisjes.

### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese, por dhe në zbatim të rekomandimeve të Progresraportit 2015 për ngritjen e një mekanizmi më efikas nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së sa më poshtë:

- Të bashkëpunojë me KLSH-në dhe Qeverinë, që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;

- Për rekomandimet në aspektin e përmirësimit të legjislacionit, sugjerohet që Kuvendi dhe KLSH-ja të organizojnë, të paktën 2 herë në vit, seanca dëgjimore me institucionet përkatëse dhe grupet e interesit, me qëllim vlerësimin e situatës ligjore dhe finalizimin e nismave ligjvënëse;

- Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar, duhet të angazhohet që të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike;

- Të shikojë mundësinë e krijimit të Nënkomisionit parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve.

Miratuar në datën 20.10.2016